



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gjiçane
Municipality of Gjiçan
Gjiçan Belediyesi

Në zbatim të nenit 46 paragrafi 2.5, nenit 58 paragrafi 2.10 të Statutit të Komunës së Gjiçanit, 01.16-126211 të datës 06.11.2014, si dhe duke u bazuar në nenin 4 paragrafi 5 të Udhëzimit Administrativ Nr.2008/10 për Organizimin dhe funksionimin e Komiteteve Konsultative në Komunë, Kuvendi i Komunës së Gjiçanit në seancën e mbajtur më 29.06.2015, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR THEMELIMIN E PANELIT PËR PËRZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË
KOMITETIT KONSULTATIV TË EKSPERTËVE TË PLANIFIKIMIT
HAPËSIONORË

1. Me këtë Vendim themelohen Paneli për përzgjedhjen e anëtarëve të Komitetit Konsultativ të Ekspertëve të Planifikimit Hapësinor me këtë përbërje::
 - 1.1. **Avdyl Aliu, anëtarë i KK-së**
 - 1.2. **Jehona Hyseni, anëtarë i KK-së**
 - 1.3. **Riad Rashiti, anëtarë i KK-së**
 - 1.4. **Selami Xhemajli, anëtarë i KK-së**
 - 1.5. **Shaban Terziu, anëtarë nga shoqëria civile**
2. Komisioni nga pika 1 e këtij vendimi ka për obligim që pas intervistimit të kandidatëve të interesuar për anëtarësim në Komitetin Konsultativ të Ekspertëve të Planifikimit Hapësinor sipas konkursit publik të shpallur nga Kuvendi i Komunës së Gjiçanit, Kuvendit të Komunës t'i propozojë listën me anëtarët për Komitetin Konsultativ të Ekspertëve të Planifikimit Hapësinor.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Njësia e Kuvendit, përderisa për monitorim të zbatimit kujdeset kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Gjiçanit.
4. Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës.

01. Nr. 016-60807
Gjiçan, më 29.06.2015

Kuvendi i Komunës-Gjiçan.

Valentina Bunjaku Rexhepi, Kryesuese